

Бр. 03-914/1
01-03-2019 20 год
СКОПЈЕ

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Бр. 03-115/1
1.03.2019 год
СКОПЈЕ

për mbështetje të ndërsjellë për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave

Duke marrë parasysh kornizën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht Konventën e Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Korrupsionit,

kompetencat ligjore të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) dhe të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë (në tekstin e mëtejme: AGjPP)

si dhe nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të ndërsjellë me qëllim të përfortimit të mëtejshëm të efektiviteti të luftës kundër korrupsionit nëpërmjet shkëmbimit të njohurive, përvojave dhe praktikave më të mira,

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, i përfaqësuar nga Biljana Ivanovska, kryetare e KSHPK-së dhe Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, e përfaqësuar nga prof. dr. Natasha Gaber-Damjanovska, drejtore e AGjPP-së, në tekstin e mëtejme "Nënshkruesit", pajtohen të nënshkruajnë Memorandum bashkëpunimi për mbështetje të ndërsjellë për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (në tekstin e mëtejme: Memorandum bashkëpunimi).

Neni 1

Ky Memorandum bashkëpunimi e rregullon mënyrën e bashkëpunimit, koordinimit dhe kryerjes së aktiviteteve të dakorduara bashkërisht midis nënshkruesve, me qëllim të parandalimit më efikas të korrupsionit dhe konfliktit të interesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

1. Nënshkruesit vendosin bashkëpunim me qëllim të shkëmbimit të përvojave, informatave, si dhe ndihmës dhe mbështetjes teknike për ta avancuar punën e tyre brenda kompetencave ligjore
2. Në kuadër të bashkëpunimit, Nënshkruesit do të mundësojnë bashkëpunim të ndërsjellë teknik dhe shkëmbim e drejtpërdrejtë të përvojave ose nëpërmjet institucioneve dhe organizatave të tjera, nëse kjo është më praktike dhe më efikase, e që kanë të bëjnë me një spektër të gjerë çështjesh që lidhen me parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, promovimin e sistemit të integritetit dhe mirëqeverisjes, që përfshin, por nuk kufizohet në:
 - a. Trajnim dhe edukim
 - b. Shkëmbim të zgjidhjeve dhe të projekteve teknike dhe të TI-së
 - c. Strategji dhe politika për përfortimin e programeve të parandalimit

- d. Hulumtime
 - e. Aktivitete për përforsimin e vetëdijes për korrupsionin, konfliktin e interesave dhe mbrojtjen e bilbilfryrësve (denoncuesve)
 - f. Zhvillimin e programeve dhe aktiviteteve për realizimin e suksesshëm të obligimeve të Nënshkruesve që dalin nga projektet dhe marrëveshjet ndërkombëtare
3. Nënshkruesit do të zhvillojnë bashkëpunim në nivelin më të lartë, dhe për këtë, sipas nevojës, do të përdorin këto mekanizma:
- a. Formimin e grupeve të punës për çështje të caktuara me interes të përbashkët
 - b. Mbajtjen e konsultimeve të përbashkëta dhe informimin e ndërsjellë
 - c. Kryerjen e hulumtimeve mbi çështjet me interes të përbashkët
 - d. Kryerjen e trajnimeve dhe edukimeve të përbashkëta
 - e. Shkëmbimi i informatave me rëndësi për mbështetjen e pjesëmarrjes në konferenca, seminare, forume, takime dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare

Aktivitetet e përfshira me këtë Memorandum bashkëpunimi do të zbatohen nga ana e KSHPK-së dhe AGjPP-së në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, aktet nënligjore dhe në suaza të mjeteve në dispozicion

Neni 2

Secili nga nënshkruesit emëron një person për komunikim, i cili do ta ndjekë bashkëpunimin.

Neni 3

Bashkëpunimi ndërmjet nënshkruesve që inicohet me këtë Memorandum bashkëpunimi do të analizohet në vazhdimësi me qëllim të avancimit të tij.

Neni 4


Memorandumi i bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit
Memorandumi i bashkëpunimit është nënshkruar në gjashtë kopje origjinale, nga të cilat dy në maqedonisht dhe dy në shqip

Nënshkruar më _____ 2019, në Shkup

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

Kryetare,

Biljana Ivanovska



**AKADEMIA PËR
GJYQTARË DHE PROKURORË PUBLIK**

Drejtore

Prof. dr. Natasha Gaber Damjanovska

